

E DIELA E SAMARITANES

THIRRTORET, T. IV

Këndohen dhjetë, domethënë katër të Tingëllit IV, tri të Mespesëdhjetores, dhe tri të Samaritanes:

PAS IKOS TU EFRATHA, T. II

Mezi i ditëve, nga Pashka në Rushajet, na ndriti me shkëlqimet, që kanë që të dyja, për shpirtet e besnikëve.

Mali Sion shkëlqen, nga drit' e Ngjalljes sate, se kjo e shoj mallkimin, për krimën që të vranë, stoliset pra dhe brohorit.

Ja ku vjen Shpirti Shenjt, Ngushëllimtari ynë, ka shkuar gjysm' e kohës, nga Kryqi dhe nga Ngjallja, Rushajet vijnë pritini.

Ndënje në një burim, Burim i ameshuar, dhe ujë po kërkonje, nga një Samaritane, o uj' e gjall' e qiellit.

Nem ujën që këcen, në jetë t' ameshuar, ta pi të mos kem etje, Samaritanja thoshte, o Zoti Krisht o Shpetimtar.

Qysh me një grua flet, me një Samaritane, për ujë si i lutesh, o Zot i tërë botës, Burim i gjithë ujëve!

LAVDI. Vajte në Samari, në pusin e Jakobit, mëkatat na i lave, dhe jetën na dhurove, Parajsën e Shenjtorëve.

TANI, T. IV. Stërgjysh' i Krishtit Profeti Shën David (Shiko Kremtoren, f. 95)

PASVARGJET, T. IV

Zoti Krisht që u-ngjite përmi Kryq, dhe e shove mallkimin e stërgjyshërve, edhe zbritë në Skëterrën, dhe çlirove të burgosurit prej jetëve, dhe u dhurove njerësve paprishjen, hymnojmë pra dhe lavdërojmë, Ngjalljen tënde shpëtimtare dhe jetëbërëse.

Pastaj Vargëzimet e Pashkës, Lavdia e Pashkës, Përlëshorja e Tingëllit IV dhe e Mespesëdhjetores. Në Shërbesën e Mëngjazit, Ndënjësoret, Dëgjimi, dhe Shkallesat e Tingëllit IV, pastaj:

SHKURTORJA, T. T. IV

Ardhi me besë në burimin tënt, Samaritanja edhe ty të pa, o uj' e shenjt' o Zoti Krisht, o Perëndi o Shpëtimtar, dhe kungoj dhe fitoj Mbretërin' e qiellit, dhe Parajsën e Shenjtorëve.

SHTEPIA

Ejani ta këndojmë Ungjillin e Shën Joanit, edhe t'i studiojmë ngjarjet mistike të Samarisë, ku kërkonte ujë prej një gruaje Zoti i ujëve të botës, që rri mi fronin me Atin dhe me Shpirtin e Shenjtë; se ardhi t'i shpëtonjë mëkatarët, edhe t'u dhuronjë Mbretërin' e qiellit, dhe Parajsën e Shenjtorëve.

SINAKSARI

Gjithë sot, të Dielën e Pestë pas Pashkës së Madhe, kremtojmë ditën e Samaritanes.

Me nërmjetimet e Dëshmores sate Fotini, o Krisht, o Perëndi, meshirona. Amin.

Zbritësoret e Pashkës, Ungjilli Mëngjesor VII (shiko Kremtoren, f. 147-8), dhe Madhështimet e Pashkës, pastaj:

DERGIMESORET, T. II

SARKI IPNOSAS

Si fjete si njeri me trup, o Mbreti ynë Zoti Krisht, u-ngjalle të tretën ditë, dhe ngritë gjyshin Shën Adam, dhe e dërmovë vdekjen krejt. Pashkë burim i jetës, shpëtim i benikëve.

TIS MATHITES SINIELTHOMEN

Në Samari o Shpëtimtar, në pusin e Jakobit, ujë kërkonje si njeri, nga një grua e mjerë, o pus i ujës së botës, dhe i dhurove ujën, e gjallë të Shenjtorëve, dhe ajo e kungoj edhe trashëgoj, lumërit' e jetës së ameshuar, kurorën e Dëshmorëve, dhe Parajsën e Krishtit.

Arriu mez' i ditëve, nga Pashka e bekuar, gjer ditën e Rushajeve, dhe Jesuj predikonte, me parabolla në tempull, dhe u thoshte atyre, që kishin etje shpirtërisht: Eni merrni një ujë nga pusi im, dhe ahëre etje s' kini askurrë, se është uja që këcen, në jetën e pasosur.

LAVDERIMET, T. IV

Këndohen tetë, domethënë katër të Tingëllit edhe katër të Pashkës së Madhe, pastaj:

LAVDI, T. T. II. Kryeburimi i jetës, Jesuj Shpëtimtari ynë, qëndroj pranë burimit të Jakobit, edhe lypte ujë

nga një grua Samaritane, edhe i dhuroj ujën e jetës së pasosur, edhe ajo lëçiti dhe thirri: Ejani dhe shikoni Perëndinë, që ardhi për të shpëtuar njerëzit.

TANI, T. T. I. Ardhi dit' e shenjt' e Ngjalljes . . .

Doksollogjia, pastaj nis Mesha. Në Hyrjen këndohen:

PERLESHORJA E TINGELLIT IV

Kur me gas mësuam Ngjalljen prej varreve, Dishepuleshat e Zotit dhe Shpëtimtarit prej Engjëllit, ahëre hojnë tej dënimin e stërgjyshërve, dhe Apostujve u thoshnin dhe mburrëshin: U-shkel prej Zotit Ferr' i zi, dhe Krishti nga varri u-ngjall, dhe njerësve u fali përdëllimin e math.

PERLESHORJA E MESPESDHJETORES, T. T. IV

E kremtja mezin arrin, dhe etje ka shpirti im, ti pra derth-ma shirin e shpresave, se të gjithë të mjerët ti i fton: Kush ka etje le të vinjë t'i jap ujë. Ti o jet' e burim, o Krisht Perëndi lavdi më ty.

Hyrtorja dhe Shkurtorja e Pashkës, Hymni Trshenjtor, dhe pastaj:

APOSTULLI

Sa të mëdha janë veprat e tua, o Zot.

Bekoje Zotin, o shpirti im.

Këndimi prej Akteve të Apostujve.

Më ato ditë, Apostujtë, të cilët ishin përndarë nga ndjekja kundër Stefanit, shkuan gjer në Fenikë dhe në Kypër dhe në Antioki, edhe nuk e lëçitën fjalën veçse

nëpër Judenjët vetëm. Edhe disa prej atyre ishin Kyprianë dhe Kirineas, të cilet arthnë në Antioki, dhe u folnë Helenistëve, dhe u predikuan Jesu Krishtin. Edhe dora e Zotit ishte me ata; edhe një numër i math besuan, dhe u-kthyen më Zotin. Edhe këto lajmë arrinë në veshin e besnikëve të Kishës së Jerusalemit; edhe këta dërguan Barnabën që të shkonte gjer në Antioki; i cili, kur vajti dhe e pa hirin e Zotit, u-gëzua, dhe i eksortonte të gjithë të qëndronin më Zotin me tërë zemrën; se ishte njeri i mirë, plot më besë dhe me Shpirt të Shenjtë; dhe u-shtua mjaft popull më Zotin. Dhe Barnaba shkoj në Tarsë që të kërkonte Saulin; edhe si e gjeti, e pruri në Antioki. Edhe për një mot të tërë mblidhëshin në Kishë, dhe mësonin një shumicë populli. Edhe dishepujtë u-quan të Krishterë për herën e parë në Antioki. Edhe një prej atyre, i quajtur Agab, u-ngrit edhe parëtha me anën e Shpirtit të Shenjtë që do të ngjante një zi e madhe në tërë botën, e cila me të vërtetë ngjau në ditët e Kesar Klaudit. Ahëre dishepujtë vëndosnë, sipas fuqisë cilido, tu dërgonin ndihma vëllezërve, që banojnë në Jude; edhe këtë e bënë, edhe i dërguan me dorën e Barnabës dhe të Saulit.

UNGJILLI PAS JOANIT

Më atë kohë, Jesuj vajti në një qytet të Samarisë, të quajtur Sihar, afër arës, të cilën Jakobi ia kishte dhënë të birit Josef; edhe atje ishte pusi i Jakobit. Jesuj, pra, i lodhur nga udhëtimi, ndënji pranë pusit; edhe ora ishte nja gjashtë. Edhe një grua prej Samarisë ardhi për të marrë uje. Edhe Jesuj i tha: "Nem të pi." Se dishepujtë e tij kishin shkuar në qytet për të blerë të ngrëna. Edhe gruaja Samaritane i tha: "Qysh ti, që je Judean,

më kërkon ujë mua, që jam një grua Samaritane? Se Judenjtë nukë kanë marrëdhënie me Samaritanët.” Edhe Jesuj u-përgjeq edhe i tha: “Po ta dinje dhuratën e Perëndise edhe cili është ay, që të thotë, ‘Nem të pi’, do t’i kërkonje ti, edhe ay do të jipte ujën e gjallë.” Edhe gruaja i tha: “O Zot, po ti nukë ke kovë, edhe pusi është i thellë; pra, qysh do ma japësh ujën e gjalle? Apo mos je më i math se Jakobi, ati ynë, i cili na e ka dhënë këtë pus, prej të cilit ka pirë ujë ay vetë, dhe të bijtë, dhe bagëtitë e tij.” Edhe Jesuj u-përgjeq edhe i tha: “Ay, që pi nga kjo ujë, do të ketë etje prapë; po ay, që pi nga uja ime, nukë do të ketë etje për jetë; se uja, që do t’i jap unë, do të bëhet një burim, që këcen në jetën e ameshuar.” Edhe gruaja i tha: “Zot, nema këtë ujë, që të mos kem etje më, edhe të mos vinj këtu për të marrë ujë.” Edhe Jesuj i tha: “Shko, thirr-e burrin, edhe eja këtu.” Edhe gruaja u-përgjeq edhe i tha: “Nukë kam burrë.” Edhe Jesuj i tha: “Mirë thua, se pate pesë burra, edhe ay, që ke tani, nukë është burri yt; këtu fole të vërtetën.” Edhe gruaja i tha: “Zot, e shoh që je profet. Tani, atërit tanë kanë adhuruar në këtë mal, po ju thoni se vëndi, ku duhet adhuruar, është Jerusalemi.” Edhe Jesuj i tha: “Moj grua, beso-më që vjen ora, kur do mos e adhuroni Atin as në këtë mal as në Jerusalem. Ju adhuroni atë, që nuk e njihni; ne adhurojmë atë që e njohim; se shpëtimi vjen prej Judenjve. Po vjen ora, dhe tani është, kur adhuronjësit e vërtetë do ta adhurojnë Atin me Shpirtin dhe me të vërtetën, se Ati kështu i do adhuronjësit. Perëndia është Shpirt, edhe adhuronjësit e tij duhet ta adhurojnë me Shpirtin dhe me të vërtetën.” Edhe gruaja i tha: “E di që vjen Mesia, i quajtur Krisht; pra, kur të vinjë, ay do na i thotë të gjitha.” Edhe Jesuj i tha: “Unë, që të flas, jam.”

Edhe mi këtë e sipër arthnë dishepujtë e tij, dhe u-çuditnë që po fliste me një grua, po asnjë nuk e pyeti: “Ç’ kërkon, a përse flet me atë?” Gruaja, pra, e la shtëmbën, edhe shkoj në qytet, edhe u tha njerësve: “Eni të shikoni një njeri, i cili m’i tha të gjitha sa kam bërë; vallë mos është ky Krishti?” Edhe ata duallnë prej qytetit, edhe vinin tek ay. Edhe në atë mes, dishepujtë i lutëshin, edhe i thoshin: “Rabbi, haj.” Po ay u tha: “Unë kam një të ngrënë, të cilën ju nuk e dini.” Dishepujtë, pra, thoshin me njëri-tjetër: “Mos i ka sjellur njeri për të ngrënë?” Edhe Jesuj u tha: “E ngrëna ime është të bën dëshirën e ati, që më ka dërguar, edhe tja mbaronj punën. A nukë thoni që duhen edhe katër muaj, edhe pastaj vjen të korrët? Ja ku ju them, ngrerini sytë, dhe shikoni arat, se u-zbarthnë dhe duhen korrur. Edhe ay, që kor, merr rogë, dhe mbleth pemë për jetën e ameshuar; që të gëzohen tok edhe ay, që mbiell, edhe ay, që kor. Se, sa për këtë gjë, është e vërtetë se tjetër mbiell, dhe tjetër kor. Unë ju dërgova të korni atë, për të cilën nukë jini munduar; të tjerë janë munduar, edhe ju kini përfutuar nga mundimi i tyre. Edhe shumë Samaritanë prej ati qyteti e besuan për fjalën e gruas, e cila dëshmonte që: “M’i tha të gjitha sa kam bërë.” Kur i arthnë, pra, Samaritanët i lutëshin të qëndronte me ata; edhe mbeti atje dy ditë. Edhe shumë më tepër besuan për fjalën e tij, edhe i thoshin gruas që: “Nuk e besojmë tani për fjalën tënde, se e dëgjuam vetë, dhe e dimë që ky është me të vërtetë Krishti, Shpëtimtari i botës.”

Pastaj Mesha vazhdon dhe mbaron si të Dielën e Myrrë-prurseve.